

KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	06/10/ 2025		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	060/04-	44110	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas



PROCESVERBAL

I

DËGJIMEVE BUXHETORE

Vendi: SHFMU “Migjeni”, Baicë

Datë: 19.08.2025

Ora: 17:30

Dëgjimet buxhetore në **Baicë** u mbajtën më **19 gusht 2025**, ku morën pjesë përfaqësues nga fshatrat **Baicë, Tërdec, Abri, Damanek dhe Krajkovë**. Në këtë dëgjim buxhetor, nga Komuna ishin të pranishëm:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Arben Shala	Nënkryetar i Komunës
Muhamet Gjoka	Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
Endrit Gllareva	Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike
Nexhmedin Gruda	Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, dhe UD i Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Kushtrim Bajraktari	ZKF-Zyrtar Kryesor Financiar
Bekim Dobra	Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun

Rendi i ditës

Dëgjimi Buxhetor filloi me këtë rend dite:

1. **Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028,**
2. **Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave,**
3. **Çështje të ndryshme.**

Hyrje

Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028

Hapjen e dëgjimit buxhetor e bëri **Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. Bekim Dobra**. Në fjalën e tij hyrëse, ai theksoi rëndësinë e organizimit të dëgjimeve buxhetore si mekanizëm i transparencës dhe i përfshirjes së qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor. Po ashtu, ai prezantoi rregullat dhe procedurat që do të ndiqeshin gjatë zhvillimit të këtij dëgjimi.

Tutje, fjalën e mori **Kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci**, i cili përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen aktive në këtë proces. Ai theksoi se dëgjimi ka për qëllim shpalosjen e projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028, si dhe mbledhjen e kërkesave e propozimeve nga qytetarët për projektet e nevojshme në komunitet.

Kërkesat

Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave

Pas fjalës përshëndetëse të Kryetarit Lladrovci, fjalën e morën përfaqësuesit e fshatrave të këtyre lokaliteteve, të cilët parashtruan kërkesat e tyre.

Përfaqësuesit e fshatrave paraqitën kërkesat e tyre. Në total u parashtruan tri kërkesa kryesore: Ndriçim publik, Infrastrukturë rrugore, Ujësjellës dhe kanalizim.

Kërkesat u pranuan dhe u regjistruan, ndërsa u dhanë përgjigje të përgjithshme nga kryetari i komunës dhe drejtorët përkatës.

Tabela e kërkesave dhe përgjigjeve

Përfaqësues / Banor	Lokaliteti	Kërkesa	Përgjigja / Sqarimi nga institucioni
Semedin Kiqina	Fshati Baicë	Ndriçim publik; asfaltim rrugicash “Mentor Kiqina” dhe “Vëllezërit Elshani”; shtrim kockash para hyrjes së shkollës	Ndriçimi publik do të realizohet brenda vitit; asfaltimi dhe shtrimi i rrugicave planifikohet sipas projektit buxhetor.
Berat Kiqina	Lagja Kiqina, Baicë	Asfaltim rruge 80 m; ndriçim publik; kanalizim	Rruga ishte pjesë e projektit, por u vonua për shkak të shkurtimeve buxhetore. Do të vendoset baza dhe do të rregullohet kanalizimi.
Arben Haziri	Damanek dhe Krajkovë	Furnizim me ujë për Krajkovën; Ndriçimi i rrugës drejt varrezave të dëshmorëve; Mungesë shtyllash elektrike në lagjen Behrami	Furnizimi me ujë do të kryhet nga KRU “Prishtina”; ndriçimi publik është në procedurë - OSHP; vendosja e shtyllave elektrike në lagjen Behrami duhet të bëhet nga KEK.

Dokumentim fotografik







Çështje të ndryshme

Nuk pati pika shtesë për diskutim.


Përfundimi

Meqenëse rendi i ditës u përmbyll, dëgjimi buxhetor u shpall i përfunduar.

Kryetari falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre.

Numri i Pjesëmarrësve		
M - 18	F - 3	Totali: 21

Procesmbajtësi


Arton Hasani

